

## **AUDITIMI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT PARASHKOLLOR**

*nga Yllka DEDE – Audituese e parë dhe Evis ÇELA – Kryeaudituese,  
botuar në gazetën “Ekonomia”, më 11 qershor 2014.*

Nisur nga ndjeshmëria e lartë në publik, rëndësia që ka mirërritja e fëmijëve tanë dhe përkujdesja e duhur ndaj tyre, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer kohët e fundit një auditim mbi performancën e shërbimit parashkollor, i cili përfshin sistemin e çerdheve dhe kopshteve të cilat frekuentohen nga fëmijët e moshës 0-6 vjeç.

Sot ky shërbim përballlet me sfida dhe me problematika të larmishme, duke filluar që nga aksesit i kufizuar në kopshte dhe çerdhe, e deri tek cilësia e diskutueshme e shërbimeve që ato ofrojnë. Për këtë arsye, auditimi u fokusua në aspektet strukturore të shërbimit parashkollor, të cilët janë të matshëm dhe përcaktohen nga një kuadër rregullator i caktuar. Në këtë drejtim, aspektet e matshme më të rëndësishme përfshijnë mjedisin fizik të institucioneve parashkollore, raportin edukatore-fëmijë dhe organizimin e shërbimit ushqimor. Rëndësi në këtë auditim i është kushtuar edhe aksesit në arsimin parashkollor të fëmijëve 5-6 vjeçarë i cili është ende i ulët, në krahasim me mesataren e vendeve të OECD. Përgjatë këtij auditimi u krye një analizë e problematikës aktuale dhe rekomandimet e tij u fokusuan në instrumentat që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për të përmirësuar situatën.

Në fokus të auditimit ishin jo vetëm fëmijët, por edhe prindërit të cilët i besojnë institucioneve parashkollore fëmijët e tyre ndërkohë që përmbushin detyrimet e tyre gjatë ditëve të punës. Por sa përkujdesje marrin në të vërtetë fëmijët tanë në kopshte e çerdhe dhe cili është niveli i arritjes së standardeve të këtij shërbimi? Qyteti i Tiranës ka aktualisht 43 kopshte dhe 31 çerdhe publike si dhe 51 kopshte private. Gjendja aktuale e shërbimit parashkollor, ku kërkesa është gati dy herë më e lartë se sa oferta, imponon një zgjedhje midis respektimit të së drejtës së çdo fëmije për tu pranuar në kopshte dhe çerdhe dhe kufizimit të numrit të fëmijëve duke synuar ruajtjen e standardeve për këtë shërbim. Jo pak herë, mediat kanë pasqyruar çdo fillim viti shkollor problematikën e rradhëve të gjata për regjistrimin e fëmijëve.

Kapaciteti aktual zyrtar në çerdhet e Tiranës është 2055 fëmijë, ndërkohë që numri total i fëmijëve të regjistruar për vitin 2013 ka qenë 3009 fëmijë duke lënë në këtë mënyrë shumë fëmijë në listë pritje. Ndërkohë në kopshte janë pranuar pothuajse të gjitha kërkesat për regjistrim, duke sjellë kështu tejkalimin në mënyrë dramatike të kapaciteteve mbajtëse të kopshteve dhe duke cënuar si pasojë “Standardet e përmbajtjes së arsimit parashkollor” ku përcaktohet se grupet duhet të jenë me 25 fëmijë.

Një alternativë ndaj shërbimit publik paraqitet dhe shërbimi privat, treguesit e të cilit vijjnë në rritje, nga 19 kopshte në vitin 2009 në 51 kopshte në vitin 2013. Gjendja e kopshteve private konsiderohet në përgjithësi e mirë pasi ato janë akomoduar kryesisht në ndërtime të reja dhe me kushte të mira, por si rezultat i çmimeve më të larta të shërbimit që aplikojnë kanë ndikuar shumë pak në përmirësimin e situatës. Për këtë arsye, KLSH ka këshilluar që Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Bashkia e Tiranës, në kushtet e kapaciteteve të kufizuara, të implementojnë një sistem regjistrimi në institucionet publike parashkollore i cili i jep prioritet pranimin të fëmijëve nga familjet me të ardhura më të ulta, si një masë afatshkurtër për të reduktuar momentalisht kërkesën e tepërt. Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit dhe Sporteve nëpërmjet mekanizmave të përshtatshme, duhet të intensifikojë politikat inkurajuese ndaj kopshteve private, si një alternativë efektive për zgjerimin e kapaciteteve dhe reduktimin e diferencës kërkesë-ofertë për shërbimin parashkollor. Këto institucione duhet të marrin gjithashtu në konsideratë kërkimin e burimeve alternative të financimit për shërbimin parashkollor, siç mund të jetë nxitja e partneritetit me donatorët vendas apo të huaj.

### ***Ndikimi i infrastrukturës së munguar***

Mbipopullimi i kopshteve dhe çerdheve në Tiranë është një fenomen i vënë re vitet e fundit dhe arsyet për këtë problematikë janë të shumta. Transformimet dramatike politike e social-ekonomike të Shqipërisë, që nga viti 1990, reflektohen në tendencat demografike të vendit si p.sh. migrim masiv urban, kryesisht drejt qyteteve më të mëdha. Si pasojë e këtyre transformimeve edhe Tirana ka ndryshuar shumë në dy dekadat e fundit. Përveç rritjes së popullsisë dhe migrimit, faktorë të tjerë që kanë ndikuar në mangësitë në infrastrukturën parashkollore ka qenë dhe trashëgimia e pakët e kopshteve dhe çerdheve nga regjimi komunist. Ndërkohë në reduktimin e numrit të institucioneve parashkollore, ka ndikuar edhe kalimi i një pjese të ndërtesave të kopshteve dhe çerdheve, tek pronarët e vjetër që i kanë pasur ato në pronësi.

Bashkia e Tiranës kishte parashikuar fonde për ndërtimin dhe rikonstruksionin e kopshteve dhe çerdheve të Tiranës, në Projekt Buxhetin e vitit 2012, Projekt Buxhetin Afatmesëm 2013-2015, në programin “Kujdesi Social” si dhe në programin për “Arsimin Parauniversitar dhe edukimin” ku përfshihet edhe “Arsimi parashkollor”. Sipas zërave të këtyre programeve, Bashkia Tiranë do të realizojë deri në vitin 2015 ndërtimin e 5 kopshteve dhe çerdhe të integruara , ndërtimin e 3 kopshteve dhe 3 çerdheve të reja dhe rikonstruksionin e 15 kopshteve dhe 5 çerdheve. Ndërkohë që deri në fund të vitit 2013, janë realizuar ndërtimi i 2 kopshte – çerdhe të integruara, ndërtimi i kopshtit nr.22, rikonstruksioni i 2 kopshteve dhe i 4 çerdheve. Ndërtimi i një kopshti si dhe ikonstruksioni i 8 kopshteve dhe një çerdheje janë aktualisht në proces. Pra sic vihet re, problematika e tejmbushjes jashtë kapaciteteve të kopshteve dhe çerdheve, është e vështirë/ të zgjidhet deri në vitin 2015 pasi deri në fund të vitit 2013, Bashkia e Tiranës, ka realizuar pjesërisht objektivat e parashikuara në programin buxhetor të saj. Kjo ka ndikuar në mungesën e infrastrukturës së nevojshme për shërbimin parashkollor. Krijimi i kopshteve private e ka lehtësuar disi këtë gjendje, por numri i fëmijëve në këto kopshte është relativisht i vogël dhe ka ndikim jo të konsiderueshëm në zgjidhjen e problematikës. Një nga faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen midis kopshteve publike dhe atyre private është çmimi i shërbimit në kopshtet private, i cili nuk është i përballueshëm nga të gjithë prindërit. Për zgjidhjen e kësaj situate emergjente, KLSH ka rekomanduar që instrumentet vendore të planifikimit duhet të vlerësojnë nivelet e ardhshme të popullsisë, nëpërmjet studimit të kushteve dhe tendencave aktuale të urbanizimit të Tiranës, me qëllim plotësimin e nevojave me infrastrukturë parashkollore për njësitë bashkiake të cilat kanë numrin më të lartë të fëmijëve 0-6 vjeç. Gjithashtu Plani i ri i Përgjithshëm Rregullues i Tiranës, duhet të marrë parasysh kërkesën e lartë për kopshte dhe çerdhe, duke përcaktuar sheshe të përshtatshme për ndërtimin të reja, si në periferinë e qytetit ashtu edhe pranë qendrës së Tiranës, ku dendësia e popullsisë është rritur ndjeshëm. Duke synuar një zgjidhje më afatgjatë për infrastrukturën e munguar të shërbimit parashkollor, Bashkia e Tiranës të konsiderojë mundësinë e integrimin të kopshteve dhe çerdheve në katet e para të ndërtesave të reja.

***Mjedisi fizik, brenda dhe jashtë institucioneve parashkollore***

Mjedisi fizik ndikon në sjelljen dhe zhvillimin e njeriut, të të rriturve dhe fëmijëve, të cilët jetojnë dhe punojnë në të. Cilësia e hapësirës fizike ndikon në nivelin e

përfshirjes së fëmijëve dhe në cilësinë e bashkëveprimit midis të rriturve dhe fëmijëve. *Mjedisi i brendshmi i institucioneve parashkollore* ndahet në mjedise mësimore dhe mjedise ndihmëse . Mjediset mësimore duhet të jenë të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin që ka çdo fëmijë. Ky mjedis duhet ti shërbejë qëllimeve të kurrikulës, në mënyrë që të sigurojë një shumëllojshmëri eksperiencash të mësuarit për të inkurajuar eksperimentimin dhe eksplorimin e fëmijëve. Brenda çerdhes dhe kopshtit duhet të ketë edhe mjedise ndihmëse ku fëmijët luajnë me fëmijët e tjerë. Mjediset ndihmëse janë mjedise të ndërvarura nga ato të veprimtarisë ditore, të cilat nxisin dhe respektojnë pavarësinë e fëmijëve. Është e domosdoshme që në këtë mjedis, çdo fëmijë të ketë hapësirën e tij për mjetet individuale. Mjedisi i brendshëm duhet të jetë në kushte higjienike shumë të mira dhe i pajisur në mënyrë të tillë që të sigurojë akomodimin e çdo fëmije në grup. Në mjediset e brendshme fëmijët mund të prezantojnë punën e tyre në grup apo individuale. *Hapësirat e brendshme*, për çdo fëmijë në kopsht, duhet të zënë një sipërfaqe minimale  $1.5 \text{ m}^2$  dhe optimale  $2.5\text{-}3 \text{ m}^2$ . Duke marrë parasysh lëvizshmërinë e madhe të kësaj grupmoshe, çdo grup duhet të ketë dy dhoma, një për aktivitete mësimore me sipërfaqe  $1.5 \text{ m}^2/\text{fëmijë}$  dhe një tjetër për aktivitetet me lëvizje dhe lodra me sipërfaqe  $2.5 \text{ m}^2/\text{fëmijë}$ . Këto standarde janë të përafërta me mesataren e vendeve të OECD, ku hapësira e brendshme për çdo fëmijë është përcaktuar  $2.9 \text{ m}^2$ .

Institucionet parashkollore janë mjedise në të cilët është parashikuar që fëmijët mund të flenë. Sipas standardeve përkatëse, gjatësia e krevateve të fëmijëve duhet të përshtatet me shtatëlartësinë mesatare sipas grupmoshave duke shtuar 25 cm. Krevatët duhet të vendosen larg nga dritaret dhe hapësira midis tyre duhet të jetë 0.5-1 m për fëmijët e kopshteve dhe 0.6 m për fëmijët e çerdheve. Gjithashtu, standardet përcaktojnë që shtetërit të vendosen në formën e lojës së shahut për të evituar respirimin e ajrit të njëri tjetrit. Por në asnjë nga kopshtet e vrojtuarat prej nesh, nuk respektohen standardet në lidhje me hapësirat si pasojë e tejmbushjes mbi kapacitetin e tyre. Shpesh fëmijët i zhvillojnë të gjitha aktivitetet në të njëjtin ambient. Pra, raporti fëmijë-hapësirë nuk është në përputhje me normat zyrtare të mjediseve fizike të kopshtit. Si pasojë e mbipopullimit nuk zbatohet asnjë nga kërkesat që lidhen me akomodimin e fëmijëve në krevatët e tyre dhe për shkak të hapësirave të vogla në dispozicion, në asnjë rast nuk është krijuar distanca e nevojshme prej 0.5-1 m nga njëri krevat në tjetrin.

Në kushtet e një mbipopullimi të tillë, ku nevojat janë sa dyfishi i kapaciteteve, çdo fëmije i është cënuar hapësira individuale e nevojshme për zhvillimin e tij, për shkak të hapësirave të ngushta, të cilat nuk i lejojnë të lëvizin lirisht dhe të zhvillojnë potencialin e plotë.

Institucionet parashkollore janë vende ku mjedisi i brendshëm ka lidhje të ngushtë me mjedisin e jashtëm. *Mjedisi i jashtëm* ka një ndikim të madh tek fëmijët me mesazhet që transmeton dhe ndikon në rritjen dhe formimin e tyre. Mjedisi i jashtëm duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme të përdorshme ku tu krijohet mundësi fëmijëve të përdorin lojërat në natyrë për çdo grupmoshë. Në këtë mjedis duhet të respektohet patjetër balanca diell-hije-gjelbërim, në mënyrë që të përdoret si për aktivitetet ditore ashtu edhe për bashkëveprimet sociale. Territori i jashtëm duhet të parashikojë 7m<sup>2</sup> për fëmijë dhe duhet të ketë rrugica të asfaltuara për të mbrojtur fëmijët nga balta ose ndotësit e tjerë. Në shumicën e kopshteve dhe çerdheve të Tiranës hapësira e jashtme në dispozicion të fëmijëve është e pamjaftueshme dhe nuk është konceptuar në përputhje me standardet. Kjo mangësi ka vështirësuar zhvillimin e aktiviteteve ditore edukuese dhe argëtuese të fëmijëve në ajër të pastër.

Një tjetër aspekt i vlerësuar nga grupi i auditimit është edhe *raporti edukatore-fëmijë* i cili si një tregues sasi i frekuencës së kontakteve ndërmjet edukatoreve dhe fëmijëve, përbën një ndër indikatorët më të rëndësishëm të matjes së cilësisë së shërbimit parashkollor. Hapësirat e pamjaftueshme dhe mbipopullimi i kopshteve/çerdheve e kanë cënuar edhe standardin e raportit optimal edukatore-fëmijë. Megjithëse Shqipëria ka vendosur teorikisht standarde korrekte dhe të krahasueshme me ato të vendeve të OECD në drejtim të raportit edukatore-fëmijë, zbatimi i këtyre standardeve është akoma shumë larg. Praktikisht, ky raport shkon nga 33 -45 fëmijë për një edukatore. Mbiipopullimi i kopshteve nuk është shoqëruar me rritje të numrit të edukatoreve për të kompensuar numrin e lartë të fëmijëve dhe për të balancuar këtë raport. Për sa i takon çerdheve, raporti 1-4 respektohet tek grupet e fëmijëve të moshës 0-18 muaj. Problematika në çerdhe vërehet tek grup moshë 18-36 muajsh, ku raporti 1 /7 shpesh tejkalohet.

Si pasojë e këtij raporti jo të drejtë edukatore-fëmijë, edukatorët përballen me një mbingarkesë të madhe dhe me vështirësi të shumta gjatë punës së tyre, duke mos harruar edhe përgjegjësinë e jashtëzakonshme që kanë për fëmijët e kësaj moshe kaq delikate. Ky raport reflektohet edhe në bashkëveprimin edukatore-fëmijë, i cili

është mjaft i kufizuar dhe detyrimisht frekuenca e kontakteve ndërmjet tyre është mjaft e ulët.

Grupi i auditimit shqyrtoi edhe *shërbimin ushqimor* të ofruar në kopshte e çerdhe, si një nga komponentët më të rëndësishëm të përkujdesjes së fëmijëve. Ushqimi dhe roli që ai luan në shëndetin e fëmijëve janë pjesë integrale e Shërbimit Parashkollor. Shërbimi ushqimor përgjithësisht është i organizuar mirë dhe pjesa më e madhe e prindërve janë të kënaqur nga ushqimi që fëmijët e tyre marrin. Megjithatë, ne kemi konstatuar se produktet ushqimore të menusë së ofruar, nuk janë plotësisht në përputhje me udhëzimet e OBSH. Në përgjithësi, 4 kategoritë e rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë janë të përfshira në menutë ditore të hartuara për fëmijët e kopshteve dhe çerdheve. Por megjithatë është konstatuar se fëmijët e moshës 3-6 vjeç marrin një nivel total më të lartë proteinash dhe karbohidratesh se sa ai i rekomanduar nga OBSH. Gjithashtu jo çdo ditë fëmijët marrin sasinë e duhur të frutave dhe perimeve. Duke qenë se janë konstatuar diferenca midis sasisë së produkteve ushqimore të rekomanduara nga OBSH dhe atyre të ofruara, ky shërbim ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Në përfundim të këtij auditimi, pas analizimit të treguesve të mësipërm dhe aspekteve të tjera më specifike, u arrit në përfundimin se *edhe pse është bërë shumë në drejtim të hartimit të standardeve sasiore dhe cilësore, për shkak të mbipopullimit të kopshteve e çerdheve, këto standarde shpesh nuk respektohen.*

Kjo situatë mund të ketë disa pasoja negative. Në aspekt afatgjatë, nëse prindërit do të detyrohen të zgjedhin midis rritjes së fëmijëve dhe punësimit të tyre, kjo mund të ketë ndikim në zhvillimin social dhe edukimin e brezave të ardhshëm. Në aspekt më afatshkurtër, kjo është një situatë e cila ka ndikim në tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Këto aspekte janë shumë të rëndësishëm dhe prandaj u ndërmor ky auditim, nëpërmjet të cilit KLSH synon të ndihmojë përmirësimin e situatës, në përmbushje edhe të funksionit të tij këshillues. Nuk duhet harruar se hyrja në çerdhe dhe kopshte është përvoja e parë e jetës kolektive për fëmijët, pasi ndërveprimi social përbën rrënjët e zhvillimit të shëndetshëm dhe një ndër kushtet më të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të tyre.